



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P. 471/2016**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.06.2016 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të KVO të datës 06.06.2016 në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Çullhaj” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-22910-02-14-2016 me objekt: “Shërbim me roje private ne SUOGJ ‘Koço Gliozheni’”, me fond limit 6.690.944 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 29.02.2016, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik ”Koco Gliozheni”.

**Ankimues:**

“Çullhaj” sh.p.k  
Rr. “Ilia Shyti”, Nd.20, H.1, Njësia Bashkiake nr.3, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik  
”Koco Gliozheni”  
Bulevardi “ Bajram Curri” Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 184, datë 17.03.2010, “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe

*Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore dhe shkallët e ankimimit të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik;

## **Public Health Sector**

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 05.02.2016 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-22910-02-14-2016 me objekt: “Shërbim me roje private ne SUOGJ ‘Koço Gliozheni”, me fond limit 6.690.944 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 29.02.2016, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik.

II.2. Në datën 29.02.2016 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 11.03.2016 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- “Start 2000”	6,292,755.68	I skualifikuar
- “Pelikani Security Group” shpk	6,332,566.20	I skualifikuar
- “Aulona Pol 1 ” shpk.	6,433,167.31	I skualifikuar

- “Çullhaj” shpk	6,434,046.36	I kualifikuar
- “S.S.X” shpk	6,434,046.36	I kualifikuar
- “Mandi-2K”	6,434,046.36	I kualifikuar
- “Siguria” shpk	6,434,046.36	I kualifikuar
- “A 2000” shpk	6,434,046.36	I kualifikuar
- “Myrto Security” shpk	6,434,047.77	I kualifikuar
- “Eurogjici Security” shpk	6,456,704.14	I kualifikuar
- “Oktapus Security” shpk	6,456,706.92	I kualifikuar
- “Flena RB” shpk	6,456,706.92	I kualifikuar
- “Trezhnjeva” sh.p.k.	6,456,706.92	I kualifikuar
- “Toni Security” shpk.	6,456,706.98	I kualifikuar
- “Internacional Security Albania” shpk	6,456,706.98	I kualifikuar
- “Snajper Security” shpk	6,456,706.98	I kualifikuar
- “Global Security” shpk	6,456,709.98	I kualifikuar
- “Ales Security” shpk	6,456,709.98	I kualifikuar
- “Arbana” sh.a	6,461,131.97	I kualifikuar

II.4. Në datën 14.03.2016 operatori ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke paraqitur argumentimet si më poshtë vijon:

1. *Të skualifikohen shoqëritë : “Çullhaj” shpk, “S.S.X” shpk, “Mandi-2K”, “Siguria” shpk, “A 2000” shpk, “Myrto Security” shpk, “Eurogjici Security” shpk.*

*Këta operatorë ekonomikë kanë paraqitur ofertën e tyre ekonomike nën kosto ligjore, pasi nuk kanë parashikuar saktë kohën e shërbimit, shtesat për turnin e dytë dhe të tretë, sigurimet shoqërore e shëndetësore, armatim.*

II.5. Në datën 15.03.2016, operatori ekonomik ankimues “Trezhnjeva” sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.6. Në datën 23.03.2016, pala ankimuese “Trezhnjeva” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 16.03.2016 operatori ekonomik “Toni Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si me poshte:

1. *Për sa i përket skualifikimit të shoqërive : “Çullhaj” shpk, “S.S.X” shpk, “Mandi-2K”, “Siguria” shpk, “A 2000” shpk, “Myrto Security” shpk.*

*Këta operatorë ekonomikë kanë paraqitur ofertën e tyre ekonomike nën kosto ligjore, pasi vlera e armatimit është nën koston e lejuar me ligj si duke iu referuar Udhëzimit të MB viti 2015 ashtu edhe duke iu referuar Udhëzimit të MB viti 2014, pasi këta operatorë ekonomikë kanë përllogaritur shpenzime për armatim 333.33 lekë vit pa tvsh, pra vlerë nën minimumin e lejuar ligjor sipas Udhëzimit nr.264/1 datë 29.06.2015.*

2. Të skualifikohen operatorët ekonomikë “Çullhaj” shpk, “S.S.X” shpk, “Mandi-2K”, “Siguria” shpk, “A 2000” shpk, pasi këta nuk provojnë se disponojnë armë të blera privatisht.”

II.8. Në datën 17.03.2016, operatori ekonomik ankimues “Toni Security ” shpk., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.9. Në datën 24.03.2016, pala ankimuese “Toni Security ” shpk. ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.10. Në datën 23.05.2016 , Komisioni i Prokurimit Publik, pasi e shqyrtoi në themel ankesën e paraqitur nga operoret ekonomike ankimues, me vendimin K.P.P. 369/2016, ka vendosur:

*“1.Të mospranojë ankesat e operatorëve ekonomikë “Trezhnjeva” sh.p.k, “Toni Security” shpk, “Aulona Pol I” shpk për procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur” me Nr. REF-22910-02-14-2016 me objekt: “Shërbim me roje private ne SUOGJ ‘Koço Gliozheni”, me fond limit 6,690,944 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 29.02.2016, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik.*

2.Autoriteti kontraktor të anullojë vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Çullhaj” shpk, “S.S.X” shpk, “Mandi-2K”, “Siguria” shpk, “A 2000” shpk, “Eurogjici Security” shpk, “Oktapus” shpk, “Flena RB” shpk, “Trezhnjeva” shpk, duke i skualifikuar ata.

3.Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4.Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

5.Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

II.11. Në datën 06.06.2016, autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik,ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin elektronik të prokurimeve, duke zbatuar vendimin K.P.P. 369/2016, datë 23.05.2016, dhe me shkresën nr. 408prot., datë 06.06.2016, protokolluar me tonën me nr. 369/2 prot., datë 07.06.2016 ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e këtij vendimi. Në këtë riklasifikim operatori ekonomik “Çullhaj” shpk rezulton i skualifikuar ne këtë procedurë prokurimi sipas vendimit KPP 369/2016 datë 23.05.2016.

II.12. Në datën 13.06.2016, operatori ekonomik ankimues “Çullhaj” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.13. Nuk rezulton që Autoriteti Kontraktor t'i ketë kthyer përgjigje ankesës së ankimuesit.

II.14. Në datën 20.06.2016, operatori ekonomik ankimues “Çullhaj” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt të paraqitur pranë autoritetit kontraktor si më poshtë:

### III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese

#### Arsyeton

III.1 Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Çullhaj” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-22910-02-14-2016 me objekt: “Shërbim me roje private ne SUOGJ ‘Koço Gliozheni’”, me fond limit 6.690.944 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 29.02.2016, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik, Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku parashikohet shprehimisht se:

*“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

*“Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”.*

Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”*

III.1.1. Nga interpretimi në tërësi i dispozitës së sipërcituar del qartë qëllimi i normës juridike lidhur me të drejtën që gëzojnë operatorët ekonomikë për të ankimuar cdo lloj vendimi të marrë nga autoriteti kontraktor i cili ka dëmtuar ose rrezikon të dëmtojë interesat e tyre në procedurat e prokurimit. Nga shqyrtimi në tërësi i ankesës të paraqitur nga ankimuesi konstatohet se ky i fundit kundërshton vendimin e autoritetit kontraktor të datës 06.06.2016 lidhur me skualifikimin e tij i cili është rrjedhojë e zbatimit të Vendimit të Komisionit të

Prokurimit Publik nr.369/2016 datë 23.05.2016. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se operatorët ekonomikë ankimues mund të kundërshtojnë vendimet e tij vetëm pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë sikundër citohet dhe në pikën 4 të dispozitivit të cdo vendimi që merr Komisioni.

III.1.2. Komisioni gjykon se në rastin konkret pretendimet e parashtruar në ankesë përbëjnë “gjë të gjykuar” për të cilat Komisioni është shprehur në vendimin nr. 369/2016 pas shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues për procedurën në fjalë, vendim i cili në bazë të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përkatësisht nenit 19/1, është administrativisht përfundimtar.

Në këtë kuptim, kjo çështje e pretenduar merr cilësinë e një çështjeje të shqyrtuar tashmë nga KPP, situatë kjo, analoge me çështjet që janë gjykuar njëherë nga gjykata, për të cilat zbatohet parimi i gjësë së gjykuar dhe për rrjedhim, *ipso lege*, pretendimet nuk mund të merren në shqyrtim.

III.1.3. Komisioni thekson faktin se fuqia e “*res judicata*” mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit administrativ përfundimtar, por edhe rrethanat e çështjes të pranuar në shqyrtim, përfundimet dhe arsyet në të cilat është mbështetur ai vendim në pjesën arsyetuese, dhe që kanë lidhje me atë që urdhëron organi administrativ në dispozitivin e vendimit të tij.

Autoriteti Kontraktor në rivlerësimin e procedurës të datës 06.06.2016 nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka zbatuar, Vendimin nr.369/2016 të Komisionit të Prokurimit Publik, i cili në pikën 2 të tij ka urdhëruar autoritetin kontraktor të skualifikojë operatorin ekonomik “Çullhaj” sh.p.k. Në këtë kuptim, Komisioni nuk gjendet përballë asnjë rrethane të re që të mund të legjitimojë ankimuesin në pretendimet e tij lidhur me rivlerësimin e datës 06.06.2016.

Sa mësipër arsyetuar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet për paraqitjen e ankesës në Komisionin e Prokurimit Publik e rrjedhimisht nuk pretendimet e tij nuk merren në shqyrtim nga KPP.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Çullhaj” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-22910-02-14-2016 me objekt: “Shërbim me roje private ne SUOGJ ‘Koço Gliozheni’”, me fond limit 6.690.944 lekë pa TVSH e zhvilluar në datën 29.02.2016, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën përkatëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.

3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1461 Protokolli; Datë 20.06.2016**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar  
Spiro Kuro**

**Anëtar  
Juliana Hoxha**

**Anëtar  
Leonard Gremshi**

**Anëtar  
Hektor Balluku**

**Kryetar  
Gentian Këri**

